M A L I I Z I
KOMUNA E GUCISË
Sekretariati për Administratë të Përgjithshme dhe Veprimtari Shoqërore
Numri: 02 –
Guci, 24.11.2026.

Adresa: rr. Čaršijska nr. 28
84326 Guci, Mali i Zi

Tel/fax: +382 51 250 157
E-mail: opstauprava@opstinagusinje.me
Portali: www.opstinagusinje.me

Në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 002/18, 034/19, 038/20, 050/22, 084/22, 081/25 dhe 098/25), nenit 9 paragrafi 1 pika 7 të Vendimit për organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Gucisë ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", nr. 055/23) dhe Vendimit për bursat e studentëve në Komunën e Gucisë ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", nr. 004/18, 003/20 dhe 019/26), Sekretariati për Administratë të Përgjithshme dhe Veprimtari Shoqërore i Komunës së Gucisë shpall:

KONKURS

për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2026/27

Të drejtën e bursës mund ta realizojnë studentët e rregullt të studimeve themelore të aplikuara dhe të studimeve themelore akademike, të cilët:

- kanë shtetësi malazeze,
- kanë vendbanim në Komunën e Gucisë,
- sipas programit mësimor të institucionit të arsimit të lartë ku studiojnë, kanë dhënë provimet e vitit paraprak të studimeve me notë mesatare së paku 8,50 dhe së paku 90% të kredive ECTS,
- e kanë regjistruar për herë të parë semestrin e vitit akademik,
- nuk e kanë përsëritur asnjë vit gjatë studimeve,
- nuk janë në marrëdhënie pune,

Bursa ndahet për një vit akademik në shumë prej 50,00 euro në muaj dhe paguhet për dhjetë muaj të vitit akademik. Bursa nuk paguhet për periudhën e absolventit.

Të drejtën e bursës për vitin e parë të studimeve e kanë nxënësit bartës të diplomës "Luča A", nëse menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme regjistrohen në studime, me kusht që:

- Janë shtetas të Malit të Zi ose kanë statusin e të huajit me qëndrim të përhershëm në Mal të Zi
- Kanë vendbanim në Komunën e Gucisë
- E kanë regjistruar për herë të parë semestrin e vitit akademik

Për shkak të mungesës së kuadrove deficitare ndahet **bursë e veçantë** për ***studimet e Mjekësisë, Arkitekturës, Ndërtimtarisë, Bujqësisë dhe Matematikës.***

Të drejtën e bursës **së veçantë** mund ta realizojnë studentët që plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Vendimin për bursat e studentëve në Komunën e Gucisë dhe të cilët, sipas programit mësimor të institucionit të arsimit të lartë ku studiojnë, kanë dhënë provimet e vitit paraprak të studimeve me notë mesatare së paku 7,50 dhe së paku 90% të kredive ECTS.

Të drejtën e bursës **së veçantë** për vitin e parë të studimeve e kanë edhe nxënësit bartës të diplomës "Luča", nëse menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme regjistrohen në studime nga fushat e kuadrove deficitare.

Përfituesit e bursës së veçantë janë të obliguar që, pas përfundimit të studimeve, punët dhe detyrat e tyre t'i kryejnë në territorin e Komunës, sipas sistemit një vit bursë – një vit punë në territorin e Komunës së Gucisë.

Bursa e veçantë ndahet për një vit akademik në shumë prej 100,00 euro në muaj dhe paguhet për dhjetë muaj të vitit akademik. Bursa nuk paguhet për periudhën e absolventit. Komuna e Gucisë dhe përfituesit e bursës së veçantë do të nënshkruajnë kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

Kandidati që konkurron për ndarjen e bursës, bashkë me aplikimin në konkurs, dorëzon dokumentet në vijim:

- formularin e aplikimit në konkurs (gjendet në faqen e internetit të Komunës së Gucisë)
- vërtetimin e vendbanimit,
- vërtetimin e regjistrimit të vitit të studimeve,
- vërtetimin e provimeve të dhëna të vitit paraprak,
- vërtetimin për numrin e kredive ECTS të fituara,
- vërtetimin për notën mesatare të arritur,
- dëshmi (deklaratë) se nuk është në marrëdhënie pune,
- dëshmi (deklaratë) se nuk merr bursë tjetër,
- llogarinë rrjedhëse të hapur në bankë në emër të studentit/studentes

Nxënësit bartës të diplomës "Luča A", të cilët kanë të drejtë bursë për vitin e parë të studimeve nëse menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme regjistrohen në studime, bashkë me aplikimin në konkurs dorëzojnë dokumentet në vijim:

- formularin e aplikimit në konkurs (gjendet në faqen e internetit të Komunës së Gucisë)
- vërtetimin e vendbanimit
- vërtetimin e regjistrimit të semestrit të vitit akademik 2026/27
- diplomën "Luča A" (student/e i/e vitit të parë)
- llogarinë rrjedhëse të hapur në bankë në emër të studentit/studentes
- fotokopjen e faqes së parë të indeksit me të dhënat bazë
- dëshmi (deklaratë) se nuk është në marrëdhënie pune,

- dëshmi (deklaratë) se nuk merr bursë tjetër.

Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të Komunës së Gucisë *https://www.opstinagusinje.me* , përkatësisht deri më **24.12.2026.**

Formularin e kërkesës për realizimin e së drejtës së bursës, të interesuarit/at mund ta marrin në arkivën e Komunës së Gucisë, ndërsa ai është publikuar edhe në faqen e internetit të Komunës së Gucisë.

SHËNIM: Aplikimet e paplota dhe të paafatshme, në të cilat nuk është përcaktuar qartë nota mesatare e vitit paraprak, nuk do të shqyrtohen!

Aplikimi me biografi dhe dokumentacion të plotë - të gjitha dëshmitë për plotësimin e kushteve të veçanta dhe të përgjithshme, dorëzohet në zarf të mbyllur në arkivën e **Komunës së Gucisë** - ndërtesa e Komunës, me shënimin: **"Aplikim në konkursin për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2026/27".**

SEKRETARIATI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME
DHE VEPRIMTARI SHOQËRORE